



# BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DHJETOR 2024

## NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT ME UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

U nënshkrua nga Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja dhe rektorja e Universitetit "Aleksandër Xhuvani" një Memorandum Mirëkuptimi, me qëllim rivitalizimin e Klinikës së Ligjit, pranë këtij universiteti, duke çuar në 13 marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici dhe Klinikave të Ligjit pranë IAL-eve.



## TË FUQIZOHEMI PËRMES INFORMACIONIT: NJË UDHËTIM ME MEDIAN KOMBËTARE PËR TË PRMOVUAR NDIHMËN JURIDIKE FALAS PËR PERSONAT VULNERABËL

Në bashkëpunim me UNDP, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici, me pjesëmarrjen e medias kombëtare vizituan dhe intervistuan Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, Pukë dhe Shkodër, mbi punën dhe suksesin e Ndihmës Juridike Falas.



## AKSESI NË DREJTËSI & NDËRMJETËSIMI

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z.Ergys Qirici prezent në seminarin me temë "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi, nëpërmjet ndërmjetësimit dhe roli i Ndihmës Juridike Falas", mbajtur në Kavajë.



## INTERVISTË NË EMISIONIN "UNË DHE E DREJTA LIGJORE"

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici mori pjesë në emisionin "Unë dhe e drejta ligjore", në Radio Tirana, për të folur mbi aksesin në drejtësi dhe bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve.



## AKTIVITETE PROMOVUESE NË BASHKITË E VOGLA

### Klos, Dibër

Në datën 05.12.2024 në ambientet e Bashkisë Kuçovë, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm z.Ergys Qirici, nënkryetarit të Bashkisë Klos z.Bashkim Dardha, si dhe institucione të ndryshme lokale.



### Sarandë

Në datën 13.12.2024 në ambientet e Bashkisë Sarandë, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm z.Ergys Qirici, kryetarit të Bashkisë z. Olti Caci dhe përfaqësuesve të tjerë nga institucionet e ndryshme vendore.



### Peqin, Elbasan

Në datën 10.12.2024 në ambientet e Bashkisë Peqin, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm z.Ergys Qirici dhe përfaqësuesve të tjerë nga institucionet e ndryshme vendore.



### Has, Kukës

Në datën 23.12.2024 në ambientet e Bashkisë Kuçovë, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndihmës Juridike Falas z.Ergys Qirici, kryetarit të Bashkisë z. Miftar Dauti dhe përfaqësuesve të tjerë nga institucionet e ndryshme vendore.



**QSHNJP Shkodër** në datën 02.12.2024 ishte pjesë e një aktiviteti në kuadër të fushatës "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore" me fokus informimin e grave dhe vajzave mbi ndihmën ligjore falas. Në aktivitet kishte përfaqësues nga Bashkia Shkodër, Dhoma e Avokatisë Shkodër dhe Organizatat Jofitimprurëse.



**QSHNJP Shkodër** në datën 03.12.2024 zhvilloi një takim informues mbi ligjin nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" pranë Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.



**QSHNJP Shkodër** në datën 30.12.2024 realizuan një takim me fokus mbi informimin ligjor dhe ndihmën juridike falas pranë shtëpisë së të moshuarve "Besa".

**QSHNJP Vlorë** në datën 24.12.2024 ka organizuar një aktivitet informues "Street Law" dhe vendosjen e posterave në kuadër të informimit të qytetarëve për shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese .



**QSHNJP Korçë** realizoi në datën 03.12.2024 një aktivitet informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, mbi ligjin Nr. 111/2017 'Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti', në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social.



**QSHNJP Korçë** në datën 03.12.2024 dhe 04.12.2024 mori pjesë në trajnimin e organizuar nga IOM me fokus mbrojtjen e personave vulnerabël brenda lëvizjeve të përziera të emigrantëve dhe refugjatëve me fokus fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë që mbërrijnë në Shqipëri.

**QSHNJP Korçë** në datën 05.12.2024 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë në kuadër të fushatës mbi "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore".



**QSHNJP Korçë** në datën 17.12.2024 mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje të realizuar nga Bashkia Devoll.



**QSHNJP Korçë** në datën 10.12.2024 në kuadër të Ditës Botërore të të Drejtave të Njeriut, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, organizoi një takim informues mbi ligjin Nr. 111/2017 'Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti'.

**QSHNJP Kavajë** mori pjesë në aktivitetin e datës 16.12.2024 me tematikë "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri" në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve , Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, Berlin Center for Integrative Mediation dhe Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara



**QSHNJP Kavajë** organizoi në datë 30.12.2024 një aktivitet informues "Street Law" me synim informimin e qytetarëve të Bashkisë Kavajë mbi ndihmën juridike falas.

**QSHNJP Pogradec** në datën 10.12.2024, në kuadër të Ditës Botërore të të Drejtave të Njeriut dhe mbylljen e fushatës mbi "16 ditët e aktivizmit të dhunës me bazë gjinore", me mbështetjen e Shërbimit Psikosocial Pogradec, organizoi në Shkollën 9 vjeçare "Kozma Basho", një takim informues mbi ndihmën juridike falas.



**QSHNJP Pogradec** në datën 13.12.2024 me mbështetjen e Shërbimit Psikosocial Pogradec organizoi në Shkollën 9 vjeçare "Gjok Shqiptari" një takim informues mbi kuadrn ligjor dhe ndihmën juridike falas.

**QSHNJP Pogradec** në datën 24.12.2024 organizoi pranë Burgut të Grave Pojskë një takim informues mbi ligjin nr. 111/2017 'Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti'.





**QSHNJP Shkodër, Malësi e Madhe**, organizoi një aktivitet “Street Law”, me synim prezantimin e qytetarëve të Bajzës me Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore dhe njohjen e tyre me ligjin nr.111/ 2017 ‘Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti’.

**QSHNJP Shkodër, Malësi e Madhe**, është fokusuar te promovimi i kësaj zyre pranë institucionve të tjera shtetërore si Njësia e Kujdesit Shëndetësor, Malësi e Madhe.



**QSHNJP Fier** në datën 10.12.2024 mori pjesë si anëtare e MKR në takimin e zhvilluar nga Bashkia Roskovec, në kuadër të mbylljes së fushatës mbi “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”. U diskutua mbi rastet e trajtuara përgjatë vitit, shërbimet e ofruara nga institucionet vendore për këto kategori, si dhe mbi të drejtat që gëzojnë në përputhje me legjislacionin vendas.

**QSHNJP Fier** në datën 10.12.2024 mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Bashkia Kuçovë me prezencën e OSBE Shqipëri, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me fokus mbështetjen e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Organizatave të Shoqërisë civile në nxitjen dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta.



**QSHNJP Fier** në datën 13.12.2024 mori pjesë në trajnimin e organizuar nga ADRF, “Për rritjen e kapaciteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe barazinë përpara ligjit”.



**QSHNJP Fier** në datën 11.12.2024 mori pjesë në takimin vijues të zhvilluar pranë Bashkisë Roskovec me fokus mbështetjen e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Organizatave të Shoqërisë civile në nxitjen dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta.

**QSHNJP Durrës** zhvilloi në datën 04.12.2024, në kuadër të fushatës mbi “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, një takim në shkollën 9 - vjeçare “14 Nëntori”, me qëllim informimin mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.



**QSHNJP Durrës** zhvilloi në datën 05.12.2024 në kuadër të fushatës mbi “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, një takim pranë Qendrës Komunitare Multifunktionale Rrushbull.



**QSHNJP Durrës** mori pjesë në aktivitetet e datës 16.12.2024 dhe 17.12.2024 me tematikë “Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri” në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve , mbajtur në Kavajë dhe Durrës.

**QSHNJP Elbasan** zhvilloi një aktivitet me mësues dhe nxënës të shkollave Dhaskal Todri, Medrese Liria, Ahmet Dakli të qytetit të Elbasanit më datë 03.12.2024, në kuadër të 3 Dhjetorit – Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuara, në bashkëpunim me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



**QSHNJP Elbasan** në datën 24.12.2024 zhvilloi një aktivitet "Street Law" në qytetin e Elbasanit, në kuadër të 10 Dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Fokusi ishte informimi i qytetarëve mbi ndihmën juridike falas.

**QSHNJP Lezhë** në datën 01.12.2024, iu bashkuan nismës së UN Women, UNFPA dhe UNDP Albania për të pedalar në rrugët e qytetit të Lezhës në mbështetje të viktimave të dhunës me bazë gjinore.



**QSHNJP Lezhë** në datën 02.12.2024 mori pjesë në një tryezë diskutimi me vajza dhe gra përfaqësuese të Këshillit Bashkiak Lezhë, anëtare të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor dhe përfaqësuese të qendrave sociale për të diskutuar mbi dhunën me bazë gjinore.



**QSHNJP Lezhë** në datën 03.12.2024 ka marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Lezhë me disa Organizata Jofitimprurëse, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

**QSHNJP Lezhë** në datën 05.12.2024 dhe 13.12.2024 ka marrë pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga Qendra "Fuqizojmë Komunitetin" Lezhë në kuadër të fushatës sensibilizuese "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore".



**QSHNJP Lezhë** në datën 11.12.2024 mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Lezhë dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut dhe përmbylljes së fushatës kundër dhunës me bazë gjinore.


**QSHNJP Lezhë** në datën 17.12.2024 organizoi një aktivitet "Street Law" me synim informimin e qytetaarëve mbi ndihmën juridike falas.

**QSHNJP Kurbin**, më datë 03.12.2024 ka realizuar një takim në kuadër të Dites Ndërkombëtare të Përsonave me Aftësi të Kufizuara me fokus informimin mbi ligjin nr.111/2017 'Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti'.



**QSHNJP Kurbin**, më datë 10.12.2024, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, ka organizuar një takim pranë Njesisë Administrative Milot me fokus informimin mbi ndihmën juridike falas.

**QSHNJP Kurbin** në datën 27.12.2024 ka zhvilluar një aktivitet "Street Law" për të njohur qytetarët me ligjin nr.111/2017 'Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti'.



**QSHNJP Berat** në datën 13.12.2024 mori pjesë në trajnimin e organizuar nga ADRF, "Për rritjen e kapaciteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe barazinë përpara ligjit". Fokus i ishte vendosur te qasja e barabartë në drejtësi.

**QSHNJP Berat** në datën 24.12.2024 zhvilloi një takim me Koordinatorin për Dhunën dhe përfaqësues të Bashkisë Berat me temë "Kategoritë e veçanta në fokus, përfitues të PAK dhe skemave të mbrojtjes sociale.



**QSHNJP Gjirokastrë** në datën 05.12.2024 dhe 06.12.2024 ka marrë pjesë në forumin konsultativ dhe trajnimin me temë "Mbrojtja e Grupeve vulnerabël në kuadër të Lëvizjeve Mikse të Migracionit me Fokusimin e Fëmijëve të Pashoqëruar dhe të Ndarë nga Shtetasit e Vendeve të Treta që mbërrijnë në Shqipëri".

**QSHNJP Gjirokastrë** në datën 09.12.2024 mori pjesë në aktivitetin e iniciuar nga UN Women dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të pedalar në kuadër të fushatës sensibilizuese "16 ditët e dhunës me bazë gjinore"

